

VENDIM
Nr. 5, datë 15.1.2026

MBI PEZULLIMIN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SUNPRO” SHPK,
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135 prot., datë 13.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SunPro’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 98, datë 12.5.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SunPro” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë.

- Në vijim, pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 148, datë 8.7.2025, pezulloi afatin e vendimmarrjes së Bordit për licencimin e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i lënë kohë asaj për depozitimin e dokumentacionit të munguar deri në datën 30.9.2025.

- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 212, datë 9.9.2025, vendosi që pika 2 e vendimit nr. 148/2025, të ndryshohet dhe të bëhet: “Brenda datës 22.11.2025, shoqëria duhet të depozitojë në ERE përgjigjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. për aplikimin e bërë për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit”.

- Në vijim të sa depozituar nga shoqëria, me vendimin nr. 319, datë 12.12.2025, Bordi i ERE-s vendosi të heqë pezullimin e procedurës dhe të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë, me qëllim zhvillimin e korrespondencës përkatëse me OST sh.a., në lidhje me pikën e lidhjes së centralit eolik me rrjetin e transmetimit dhe me vetë shoqërinë në lidhje me afatet e vënies në punë të centralit.

- Me shkresat nr. 1648/23 prot., dhe nr. 1648/24 prot., datë 18.12.2025, ERE ka njoftuar përkatësisht shoqërinë “SunPro” sh.p.k. dhe OST sh.a., për zhvillimin e një seance dëgjimore.

- Seanca është zhvilluar në ERE në datën 23.12.2025, ku përfaqësuesi i OST sh.a. bëri me dije se pasi është pajisur me miratim paraprak, shoqëria ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e pikës së lidhjes, procedurë e cila po ndiqet nëpërmjet një grupi pune dhe u mor angazhimi për të depozituar në ERE një përgjigje, në lidhje me aplikimin e shoqërisë brenda muajit dhjetor 2025. Ky angazhim iu kujtua OST sh.a. me e-mail-in e ERE-s nr. 1648/28 prot., datë 24.12.2025. Nga OST sh.a. nuk rezultoi të jetë depozituar ende ndonjë përgjigje, por sikurse është sqaruar dhe në seancën përkatëse dëgjimore, aksesin në rrjet është i garantuar për subjektet që pajisen me autorizimin/miratimin përkatës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një burimi të ri gjenerues të energjisë elektrike.

- Nga përfaqësuesit e shoqërisë u bë me dije se do të përditësohet në vijim informacioni në lidhje me vitin e ndërtimit dhe datën e fillimit të operimit dhe do të depozitohen në ERE

raportimet përkatëse të depozituara në MIE, në kuadër të ecurisë së zhvillimit të projektit eolik. Nëpërmjet *e-mail*-it nr. 1648/27 prot., datë 24.12.2025, ERE i ka dërguar shoqërisë një përmbledhje të sa diskutuar në seancë, ku i është sjellë në vëmendje dhe detyrimi për të dërguar në ERE informacionin/dokumentacionin shtesë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1648/29 prot., datë 29.12.2025, shoqëria ka bërë me dije se i është drejtuar MIE-s, ku pasi e ka informuar për ecurinë e projektit dhe pengesat e hasura, ka kërkuar rishikimin e afatit për pajisje me leje ndërtimi, ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik, me 18 muaj, ndaj përditësimi i parashikimeve të datës së ndërtimit dhe vënies në punë të centralit, mbetet i kushtëzuar nga përgjigjja dhe konfirmimi i autoritetit kontraktor. Kjo shkresë është depozituar dhe në ERE.

Pezullimi i afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 66, pika 1 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kur shqyrtimi i një çështjeje administrative varet nga një çështje tjetër ligjore e pavarur (“çështje paraprake”), për të cilën është kompetente një gjykatë ose organ tjetër, organi administrativ ka të drejtë të pezullojë procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë dhe njofton palët për pezullimin.

- Gjithashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë, rast pas rasti, pezullimin e vendimmarrjes pas fillimit të procedurës.

- Për gjithë sa më sipër, për sa informuar e depozituar nga shoqëria, referuar dhe parashikimeve të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, vlerësohet pezullimi i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë deri në depozitimin në ERE të përgjigjes/qëndrimit të MIE-s për kërkesën e bërë nga shoqëria, në lidhje me shtyrjen e afateve për pajisjen me lejet e nevojshme, ndërtimin dhe vënien në punë të parkut eolik.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, deri në depozitimin në ERE nga shoqëria të përgjigjes/qëndrimit zyrtar të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, lidhur me kërkesën e saj për shtyrjen e afateve për pajisjen me lejet e nevojshme, ndërtimin dhe vënien në punë të parkut eolik.

2. Ky vendim do t’i nënshtrohet rishikimit nga ERE pas depozitimit nga ana e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. të dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SunPro” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti